

Ne fokus/ Tifozet kuqezi “takojne” nga afer Adnan Januzajn

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 07 Dhjetor 2013 22:02



Disa shqiptare, tifozet e Manchester United kanë përfituar nga rasti për të takuar nga afër Adnan Januzajn. Me një mesazh të madh për të janë ulur në “Old Trafford” dhe e kanë ftuar 18 vjeçarin të thotë po Shqipërisë. Në ndeshjen me Newcastle, Januzaj i ka parë tifozet shqiptare por nuk u ka folur atyre duke mos bërë asnjë reagim emocional për këtë mesazh të dedikuar për të. Kjo fushatë ka nisur prej muajsh dhe kjo ishte levizja e radhës që kanë bërë tifozet shqiptare për të bindur 18 vjeçarin Adnan Januzaj të mos refuzoj Shqipërinë. Me parë i është hapur një grup me mijra fansa në Facebook, janë thurur kenge për të dhe janë shkruar shumë komente në faqet e tij në internet. Januzaj ende nuk ka dhënë një përgjigje përfundimtare se cilën kombetare do të zgjedhi për të luajtur.